

VENDIM
Nr. 535, datë 8.7.2020

**PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E
PROGRAMIT TË PUNËVE PUBLIKE NË KOMUNITET**

(Ndryshuar me vendimin nr. 270, datë 29.4.2022; Vendimin nr. 241, datë 17.4.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet.

2. Programi i punëve publike në komunitet është një program 12-mujor, i cili ka qëllim përfshirjen në tregun e punës të punëkërkuësve të papunë afatgjatë nëpërmjet ofrimit të mundësive të trajnimit dhe të punësimit me kohë të pjesshme në aktivitete me fokus shërbimet në dobi të komunitetit.

3. Fushat e veprimtarisë së programit të punëve publike në komunitet përfshijnë:

- a) shërbimet e kujdesit për fëmijët;
- b) shërbime të kujdesit shëndetësor dhe social;
- c) shërbime të rehabilitimit të ish-përdoruesve të substancave narkotike;
- ç) punime dhe shërbime për komunitetin dhe mjedisin;
- d) shërbime këshillimi dhe informacioni;
- dh) shërbime rinore;
- e) sport;
- ë) art, turizëm dhe kulturë.

II. PROGRAMI

1. Programi i punëve publike në komunitet zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, më poshtë AKPA, në bashkëpunim me organizatat e përcaktuara në pikën 5, të kreut III, të këtij vendimi, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e kësaj Agjencie, përfshirë aspektet financiare, ato të menaxhimit dhe të trajnimit.

2. Kohëzgjatja e mbështetjes së ofruar nga ky program është 12 muaj.

3. Punëkërkuësit e papunë, pjesëmarrës në këtë program, angazhohen 20 orë në javë, gjatë 5 (pesë) ditëve të javës. Pjesën tjetër të ditës së punës punëkërkuësit e papunë pjesëmarrës mund të angazhohen në trajnime shtesë. Trajnimi kryhet në qendrat publike të formimit profesional ose në ato private të licencuara.

4. Në dispozicion të punëkërkuësve të papunë, pjesëmarrës në këtë program, vihet një mbikëqyrës, sipas pikës 9, të kreut III, të këtij vendimi, i cili është përgjegjës për zhvillimin e planit individual të trajnimit (PIT) për çdo person të punësuar në projekt dhe për garantimin e zbatimit të këtij programi.

5. PIT-ja mund të përfshijë trajnime më të avancuara ose të specializuara të aftësive apo dhe mund të ofrohet si mbështetje për njohuritë bazë të shkrimit dhe të leximit. Ndërsa një pjesë e trajnimit duhet të trajtojë një gamë të gjerë temash që lidhen me jetën dhe me punën për një orientim më të mirë në tregun e punës.

6. PIT-ja miratohet nga strukturat përkatëse të AKPA-së.

III. KRITERET E KËRKESËS

1. *Punëkërkuësit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuësit e papunë të regjistruar në zyrën e punës, të moshës mbi 21 vjeç, të cilët evidentohen nga ndërrëprimi me sistemin tatimor se kanë më shumë se 12 muaj të papunë, pasi të kenë marrë shërbimet e nevojshme të punësimit, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Nevojat*

dhe profili i punëkërkuessit duhet të përshtaten me kërkesat për aftësi të vendit të punës që siguron programi për ta.

2. Punëkërkuessit, pjesëmarrës në këtë program, në rast largimi, mund të zëvendësohen vetëm gjatë tremujorit të parë të programit.

3. Një punëkërkuess mund të marrë pjesë vetëm një herë në këtë program, brenda një periudhe pesëvjeçare.

4. Punëdhënësit, të regjistruar në zyrën e punës, me të drejtë përfitimi në këtë program, janë:

- a) organizata jofitimprurëse;
- b) organizata të shoqërisë civile;
- c) biznese sociale/sipërmarrje sociale/ndërmarrje sociale;
- ç) institucione publike.

5. Punëdhënësit duhet të jenë të specializuar në fushat e përcaktuara në pikën 3, të kreut I, të këtij vendimi, të cilët zbatojnë projekte me interes publik, në nivel vendor dhe në favor të komunitetit, të cilët kanë kapacitetet dhe eksperiencën e duhur për zbatimin e këtyre projekteve.

6. Punëdhënësit, sipas pikës 4, të kreut III, të këtij vendimi, duhet të jenë të regjistruar sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe të kryejnë aktivitete në përputhje me qëllimin e përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

7. Punëdhënësit, sipas pikës 4, të kreut III, të këtij vendimi, duhet të kenë shlyer detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Punëdhënësit, pjesëmarrës në këtë program, mbartin të gjitha përgjegjësitë dhe detyrimet e mbikëqyrjes dhe të punësimit, sipas legjislacionit në fuqi.

9. *Punëdhënësit kanë të drejtë të aplikojnë për dy grupe maksimumi, me numër jo më të madh se 12 (dymbëdhjetë) punëkërkuess të papunë secili grup.*

10. *Punëdhënësi ka për detyrë të punësojë një mbikëqyrës për çdo grup përfutuesish, nga 1 në 24 pjesëmarrës, i cili mund të punojë deri në 40 orë në javë.*

11. Në rast largimi të mbikëqyrësit, punëdhënësi është i detyruar ta zëvendësojë atë duke njoftuar në AKPA dhe, kjo e fundit, të japë miratimin. Në rast të kundërt, duhet të kthejë 100% të subvencioneve të përfutura për pjesën e punëdhënësit.

12. Mbikëqyrësi ka për detyrë të ndjekë me përpikëri mbikëqyrjen e punëkërkuessve, pjesëmarrës në program, sipas kushteve të kontratës për zbatimin e projektit, lidhur ndërmjet punëdhënësit, punëmarrësit dhe AKPA-së.

IV. MBËSHTETJA E PËRFITUESVE

1. *Për punëdhënësit përfutues, sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 4, të kreut III, financimi do të kryhet në formë granti, ndërsa për punëdhënësit sipas shkronjës "ç", të së njëjtës pike, financimi do të kryhet drejtpërdrejt në llogarinë e pjesëmarrësve përfutues në program.*

2. Për punëkërkuessit e papunë, pjesëmarrës në program, financimet janë, si më poshtë vijon:

a) Financim i pagës në shumën 50% të pagës minimale, në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

b) *Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit dhe të punëmarrësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së programit.*

c) Kupon për trajnim të punëkërkuessve të papunë, pjesëmarrës në program, deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë, në rastet kur trajnimet e miratuara nuk ofrohen nga ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional.

ç) Për përfutuesit jetimë që përfitojnë nga ky status edhe pasi kanë kaluar moshën 25 vjeç, sipas legjislacionit në fuqi, prindër të vetëm me fëmijë nën 6 vjeç, *personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore, përfutues të ndihmës ekonomike, romë dhe egjiptianë mbulohen edhe shpenzime të tjera, si më poshtë vijon:*

i. bonus për shpenzimet e transportit mbulohen për të gjitha kategoritë e mësipërme, të cilët e kanë vendbanimin mbi 2 km nga vendi i punës, në vlerën prej 1 800 (një mijë e tetëqind) lekësh në muaj;

ii. *për prindërit e vetëm ose prindërit e rinj të moshës 25–29 vjeç me fëmijë nën 6 (gjashtë) vjeç të jepet një bonus në vlerën prej 4 000 (katër mijë) lekësh në muaj për kujdesin e çdo fëmije në ngarkim.*

për prindërit e vetëm me fëmijë nën gjashtë vjeç, jepet bonus në vlerën prej 3 000 (tre mijë) lekësh në muaj, për ndjekjen e kopshteve dhe të çerdheve, për çdo fëmijë në ngarkim;

iii. financim deri në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë për një person, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona, për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës, për personat me aftësi të kufizuara, *në të cilën përfshihen edhe mjetet ndihmëse në vendin e punës, literaturë/informacion të përshtatur dhe përkthime për personat me dëmtime shikimi ose dëgjimi, asistent personal në vendin e punës, transport të përshtatur, aksesueshmëri të mjedisit të punës.*

3. Për punëdhënësin, pjesëmarrës në program, financimet janë, si më poshtë vijon:

a) Për mbikëqyrësin, financim të pagës në shumën:

i. 50% të pagës mesatare në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, *për grupin nga 1–12 punëkërkuar të papunë pjesëmarrës, për 20 orë në javë;*

ii. 100% të pagës mesatare në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, *për grupin nga 1–24 punëkërkuar të papunë pjesëmarrës, për 40 orë në javë.*

b) Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës mesatare në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.

c) Tarifë për mbulimin e shpenzimeve materiale, të nevojshme për zbatimin e projekteve të punësimit në komunitet, në shumën totale deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo përfitues, këto të justifikuar me fatura tatimore, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Për punëdhënësit përfitues, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 4, të kreut III, granti financiar do të disbursobet në këste të pagueshme, si më poshtë vijon:

i. Kësti i parë: 30% (tridhjetë për qind) e vlerës totale të grantit të disbursuar me nënshkrimin e marrëveshjes;

ii. Kësti i dytë: 20% (njëzet për qind) e vlerës totale të grantit të disbursuar, pas muajit të dytë të zbatimit të programit;

iii. Kësti i tretë: 20% (njëzet për qind) e vlerës totale të grantit të disbursuar, pas muajit të gjashtë të zbatimit të programit;

iv. Kësti i katërt: 20% (njëzet për qind) e vlerës totale të grantit të disbursuar, pas muajit të nëntë të zbatimit të programit;

v. Kësti i fundit 10% (dhjetë për qind) me përfundimin e kontratës dhe të përmbushjes së të gjithë objektivave në planin individual të trajnimit.

Për punëdhënësit përfitues sipas shkronjës “ç”, të pikës 4, të kreut III, të gjitha shpenzimet do të kryhen në llogarinë personale të përfituesve dhe degën e tatimeve përkatëse çdo muaj.

V. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT

1. AKPA-ja, nëpërmjet strukturave të saj, publikon informacionin e nevojshëm në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në platforma të tjera (faqe interneti, media sociale, shtyp) në lidhje me zbatimin e programit dhe informon rregullisht punëdhënësit dhe punëkërkuarët e regjistruar.

2. Në fillim të çdo shpalljeje për *kërkesë*, AKPA-ja harton dhe publikon termat e referencës, së bashku me kriteret e *kërkesës* dhe të vlerësimit sipas këtij vendimi, fushat dhe vlerat e financimit, si dhe afatet dhe procedurën e *kërkesës*. AKPA-ja, në varësi të programit që do të financohet, përcakton dhe miraton kritere të veçanta, të cilat përfshihen në dokumentet e konkurrimit dhe shpallen publikisht.

3. Punëdhënësit paraqesin *kërkesën* për përfshirjen në program nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formularin e *kërkesës* të plotësuar, sipas modelit standard të miratuar dhe të publikuar nga AKPA-ja;

b) autorizimin e punëdhënësit, me të cilin autorizohet AKPA-ja për të kryer të gjitha verifikimet dhe kërkimet e nevojshme të dokumenteve dhe të të dhënave të *kërkesës*;

c) vetëdeklarim mbi mospasjen në ngarkim të punëdhënësit të shkeljeve apo të sanksioneve që lidhen me legjislacionin e punës, gjatë dy viteve të fundit;

ç) vendimin e regjistrimit nga gjykata e rrethit gjyqësor, origjinal ose fotokopje e noterizuar (vetëm organizatat);

d) kopje të statutit të organizatës, origjinal ose fotokopje e noterizuar (vetëm organizatat);

dh) kopje e noterizuar e NIPT-it (vetëm organizatat);

e) licencë/leje të vlefshme për ushtrim veprimtarie, origjinal ose fotokopje e noterizuar, nëse veprimtaritë e kërkuara për t'u financuar nuk mund të kryhen, sipas ligjit, pa zotëruar një licencë të akorduar nga autoritetet publike.

4. Pas marrjes së *kërkesës* nga punëdhënësi, struktura rajonale e punësimit kryen verifikimet e përmbushjes së kriterëve të punëdhënësit, nëpërmjet dokumenteve të paraqitura dhe nxjerr nga sistemi ekstraktin historik të punëdhënësit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (për bizneset sociale/sipërmarrjet sociale/ndërmarrjet sociale), si dhe vërtetimin për pagimin e detyrimeve tatimore, ku konfirmon se nuk ka detyrime tatimore.

5. Struktura rajonale e punësimit, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga momenti i *kërkesës*, verifikon plotësimin e kushteve formale paraprake të *kërkesës* dhe përputhshmërinë e tij me rregullat e zbatueshme të programit. Në rast të mosplotësimit të kushteve paraprake, struktura rajonale e punësimit i kërkon aplikuesit plotësimin e dokumentacionit.

6. Në rast të plotësimit të kushteve paraprake, në bashkëpunim me strukturën vendore të punësimit dhe punëdhënësin, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga momenti i plotësimit të dokumentacionit, hartohet lista e pjesëmarrësve punëkërkues të papunë në program, dhe projekti paraqitet në Komisionin e Miratimit të Programeve të Nxjitjes së Punësimit. Komisioni ka detyrën e vlerësimit të secilit *kërkesë*, brenda 5 (pesë) ditëve pune, me qëllim miratimin ose refuzimin e tij, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) projektet duhet të jenë jo për qëllime komerciale dhe fitimi;

b) punëdhënësit kanë kapacitetin e ofrimit të një programi trajnimi të mirëorganizuar dhe me variacion për të gjithë pjesëmarrësit;

c) punëdhënësit kanë kapacitet për të ofruar përvojë pune ose aftësi, të cilat mund të transferohen në tregun e hapur të punës dhe të mbështesë personin e papunë drejt një progresi më të lehtë;

ç) punëdhënësit kanë kapacitet për të ofruar zhvillim dhe trajnim për pjesëmarrësit, të orientuar veçanërisht drejt rritjes së gatishmërisë së pjesëmarrësve, për të marrë pjesë në tregun e hapur të punës, me objektiva të qartë dhe mbështetje për progres;

d) punëdhënësit kanë kapacitet për ta administruar projektin me sukses, për sa u përket financave, regjistrave financiarë dhe jofinanciarë, detyrimeve ligjore etj.;

dh) programi i punës së punëdhënësve nuk duhet të ketë pjesë të tij asnjë promovim/advokim të:

- i. një partie specifike politike ose të politikave të një partie specifike politike;
- ii. një besimi specifik fetar ose kishe, përveçse nëse kufizohet qartësisht tek anëtarët/ithtarët e asaj kishe/atij besimi;
- iii. ndonjë kult (laik ose fetar);

7. Struktura rajonale e punësimit i komunikon punëdhënësit aplikues përgjigjen përfundimtare mbi pranimin apo refuzimin e *kërkesës*, brenda 2 (dy) ditëve pune.

8. Punëdhënësi dhe punëkërkuesi i papunë, në cilësinë e punëmarrësit, lidhin një kontratë pune, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, në përputhje me programin. Një kopje e kontratës së punësimit mbahet në strukturën rajonale të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, i cili monitoron zbatimin e saj deri në përfundim të projektit.

9. Pas nënshkrimit të kontratës së punës, sipas pikës 8, të kreut V, të këtij vendimi, ndërmjet strukturës rajonale, punëdhënësit dhe punëkërkuesit të papunë pjesëmarrës në program, nënshkruhet marrëveshja trepalëshe për zbatimin e programit.

10. Për pjesëmarrësit në program, të cilët kanë qenë përfitues të ndihmës ekonomike, struktura vendore informon institucionin përgjegjës për shërbimin social.

11. Nëse punëdhënësi zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën me përfituesin, punëdhënësi është i detyruar të kthejë 100% të mbështetjes financiare të përfituar deri në atë moment, për rastet e zgjidhjes së kontratës për shkaqe të paarsyeshme ose të pajustificuara.

12. Nëse punëdhënësi nuk respekton marrëveshjen trepalëshe për zbatimin e programit, ai përjashtohet nga pjesëmarrja në program për një periudhë katërvjeçare.

13. *Shfuqizuar (me Vendimin nr. 341 datë 17.4.2024)*

14. Monitorimi i zbatimit kryhet nga strukturat përkatëse të punësimit.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit përcakton çdo vit prioritetet për programet e nxitjes së punësimit sipas zonave gjeografike, sektorëve ekonomikë dhe nevojave të punëkërkesve dhe miraton planin e zbatimit të fondeve të nxitjes së punësimit, pas propozimit nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-së.

2. AKPA-ja përgatit raportin vjetor brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe strukturës përgjegjëse të ndihmës shtetërore.

3. AKPA-ja ruan të dhënat për programet 10 (dhjetë) vjet, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Vlerësimi i ndikimit të programeve kryhet çdo katër vjet nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, nëpërmjet ekspertëve ose organizatave me përvojë në këtë fushë.

5. Afati i zbatimit të programit është *10 (dhjetë)* vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Ngarkohet drejtori i Përgjithshëm i AKPA-së për miratimin e rregullores së zbatimit të programit, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i shtetit, zëri “Nxitja e punësimit”.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama